



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/566

Datë: 24.12.2021

PROCESVERBAL

i mbledhjes inauguruese të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI DITËS

1. Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë.
2. Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës së Malishevës
3. Kryesimi i mbledhjes nga anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës së Malishevës
 - Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës
 - Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës
4. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës së Malishevës
5. Mbyllja e seancës.

Mbledhja u mbajt me datë: 01.12.2021 dhe filloi në ora: 10:15. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 29 asambleistë, Kryetari z.Ekrem Kastrati, ish-kryetarët z. Ragip Begaj, z.Jakup Kastrati, z.Daut Krasniqi, përfaqësues të Bashkësisë Islame, zyrtarë nga MAPL-ja, Tv Malisheva dhe zyra për informim.

Hajdin Berisha: I nderuar z. Begaj, të nderuar ish- Kryetarë të Komunës, i nderuar përfaqësues i Shoqatës së dalur nga Lufta e UÇK-së, të nderuar përfaqësues të Bashkësisë Islame, i nderuar ish- Kryesues Rrahim Morina, të nderuar përfaqësues nga MAPL-ja dhe gjithë ju të pranishëm përshëndetje për të gjithë ju!

Meqenëse festat e nëntorit sapo i kaluam, në shenjë nderimi të të gjithë dëshmorëve të kombit, ju ftoj për një minutë heshtje. Lavdi!

Sapo e kemi përfunduar një proces të rregullt zgjedhor. Një falënderim i posaçëm është për të gjitha subjektet politike, të cilat kanë garuar në këto zgjedhje dhe për qytetarët e Komunës së Malishevës, të cilët kanë kontribuar që ky proces të jetë i rregullt dhe të kalojë në mënyrën më dinjitoze, me një pjekuri të lartë politike.

Fillimisht do të të bëhet vërtetimi i pranisë fiziket ë asambliestëve. Ju lutem me ngritje dore të më konfirmoni praninë tuaj këtu.

Hajdin Berisha

Blerim Thaqi

Rukije Bytyqi

Jahir Xhyliqi

Amrush Helshani

Bashkim Krasniqi

Urim Thaqi

Avdi Morina

Besartë Ramaj

Fjoralba Hoxha

Mirlinda Gashi

Burim Paqarizi

Valjete Hoti

Nebih Bibaj

Alban Kastrati

Bledar Kryeziu

Sadik Vrenezi

Arlindë Rudi

Labinot Gashi

Argjend-Thaqi

Driton Kastrati

Driton Kastrati

Hamit Lima

Zamire Morina

Adile Hoxha
Veton Zogaj
Valon Krasniqi
Arlind Morina
Agnesa Kastrati
Arbnore Hoti
Kastriot Berisha: Mungon
Donjeta Shijaku: Mungon.
Prezent në sallë janë 29 asambleistë.
Donjeta Shijaku i bashkohet mbledhjes.

Sipas rendit të ditës dhe sipas ftesës që ka bërë Kryetari i Komunës, për këtë seancë solemne parashihet dhënja e betimit të asambleistëve dhe dhënja e betimit të Kryetarit të Komunës së Malishevës.

Unë po filloj me leximin e deklaratës së betimit të asambleistëve. Ju ftoj që të ngriteni në këmbë. Në bazë të nenit 35, paragrafi 4.5 të ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/15 qeshor 2008), neni 20 paragrafi 7.8 me Statusin e Komunës së Malishevës, nr.01/571 datë: 12.11.2008 të gjithë antarët e kuvendit të Komunës së Malishevës duhet të nënshkruajnë betimin solemn si në vijim:

Unë, Hajdin Berisha betohem se do t'i kryej me nder dhe besnikëri, pa anime dhe me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltarë i Kuvendit të Komunës së Malishevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë.

Të nderuar asambleistë ju dëshiroj punë të mbarë dhe suksese!

Në vazhdim ftoj Kryetarin e Komunës së Malishevës z. Ekrem Kastratin që ta japë betimin para asambleistëve.

Ekrem Kastrati: Përshëndetje për të gjithë! Në bazë të nenit 57, paragrafit 57.1 të Ligjit 03/ L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/15 qeshor 2008), neni 30 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kryetari i Komunës jep betimin e deklaratës solemne, para antarëve të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Unë, Ekrem Kastrati betohem që do t'i kryej detyrat e mia dhe do të t'i ushtroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Malishevës, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të ju siguroj kushtet për një jetë më të qetë për të gjithë.

Përshëndetje gjithë ju të pranishëm! Përshëndetje Kryetari Begaj dhe ju ish kryetar të komunës së Malishevës z.Jakup Kastrati dhe z. Daut Krasniqi, përfaqësues të Shoqatës së dalur nga Lufta, përfaqësues të Bashkësisë Islame, përfaqësues të pushtetit lokal, e dashura familja ime faleminderit për prezencën! Falenderim i veçantë për antarët e rinjë të asambles komunale, që së bashku me mua sot u betum, që të vazhdojmë me punë të ndershme dhe në interes të qytetarëve të Komunës së Malishevës. Fillimisht, dua të falënderoj nga zemra gjithë qytetarët

tanë, që jetojnë e veprojnë anekënd Malishevës, për kulturën e pjekurinë e lartë politike që kanë treguar gjatë procesit të fundit zgjedhor, duke e kthyer kështu qytetin tonë në një shembull që di t'i kontribuoj forcimit të demokracisë.

Të dashur qytetarë të Malishevës,

Kjo ditë është shumë e veçantë për mua, dhe shumë e rëndësishme për Komunën e Malishevës, për përfaqësuesit e zgjedhur dhe gjithë qytetarët tanë, sepse nga sot edhe zyrtarisht po e fillojmë së zbatuari një përgjegjësi shumë të madhe që ju ma keni besuar, e për të cilën ju falënderoj dhe u jam jashtëzakonisht mirënjohës që më keni përkrahur përmes të drejtës tuaj të garantuar me ligj.

Sot, si rrallë herë po ndihem krenar e me vullnet të madh, që gjithë atë besim e vlerësim që me keni dhënë, po filloj t'ua kthej me punë te mira e të ndershme, në mënyrë që gjithë këtë krenari që kam unë sot, ta trasoj nesër tek ju qytetarë të dashur të Malishevës.

Asnjëherë në jetën time, kudo që kam shërbyer, pozitat shtetërore nuk i kam parë si privilegj, por si përgjegjësi e detyra të shenjta, dhe mbi të gjitha, si mundësi të arta që sado pak ta ndihmojmë shoqërinë, ta zhvillojmë vendin tonë për të cilin të gjithë jemi krenarë.

Qytetarë të dashur,

Besimi që na keni dhënë për ne ka vlerë të madhe. Ju na keni vlerësuar, ju e keni konfirmuar punën e mirë të qeverisjes tonë, dhe ne sigurisht që me një dinamikë edhe më të madhe do të vazhdojmë të punojmë e të realizojmë shumë projekte të mira, të cilat edhe ju i prisni.

Të nderuar të pranishëm,

Më lejoni që të ritheksoj edhe një herë, ashtu siç e kam thënë mjaftueshëm prej që e kam nisur këtë rrugëtim politik: Fokusi im është zhvillimi i Malishevës Urbane dhe qëllimi im është që qytetarët e Komunës së Malishevës të kenë trajtim të barabartë në marrjen e shërbimeve që meritojnë.

Si një ithtar i parimit të bashkëvendimmarrjes me qytetarët, ju premtoj se pavarësisht sfidave që mund të kemi gjatë këtij rrugëtimi qeverisës që sot po e nisim, ne, për asnjë moment nuk do të ndalemi deri në jetësimin e vizionit tonë për Malishevën Urbane.

Një qeverisje e mirë dhe e suksesshme është vetëm ajo që bashkëvepron me qytetarët, i harton politikat bashkë me komunitetin, dhe ashtu siç i nis edhe i përfundon projektet në koordinim të plotë me ta, dhe për ta bërë këtë synim realitet, unë bashkë me trupën qeverisëse për asnjë moment nuk do t'i shmangemi kësaj rruge.

Unë dua që qytetarët tanë të bëhen pjesë e punës sonë të përditshme, por para se gjithash, ata kanë nevojë për më shumë lehtësira në marrjen e shërbimeve administrative dhe jo vetëm, sepse koha është shumë e vlefshme dhe burokracia e panevojshme.

Të dashur qytetarë të Malishevës, të nderuar të pranishëm, asamblastë të respektuar,

Çdo punë e mirë e qeverisjes Begaj është duartrokitur si sukses, vlerësimi qytetar që kemi marrë ka treguar qartë se në këto 8 vite është punuar e Malisheva është zhvilluar, por kjo nuk duhet të na bëjë komod, përkundrazi ne duhet të punojmë edhe më fort, që t'i vazhdojmë projektet që janë në proces, në mënyrë që më pas Malishevën ta çojmë në një stad tjetër të zhvillimit e përparimit, deri në urbanizimin e plotë të saj, për çka edhe shoqëria jonë e pret me padurim.

Të dashur asamblastë të pranishëm,

Jam i sigurt që me të gjithë ju do të jem shumë bashkëpunues, të barabartë do të jeni, cdo herë do të keni trajtimin, respektin e konsideratën time të plotë, pavarësisht bindjeve politike, sepse unë besoj fuqishëm dhe pa shmangshëm, të gjithë ne bashkë e kemi për synim kryesor zhvillimin e Malishevës dhe mbrojtjen e interesit të qytetarëve.

Të dashur qytetarë,

Programi zgjedhor të cilin e kam prezantuar, nga do që kam shkuar e me këdo që jam takuar, do të jetë një pikë e fuqishme referuese mbi të cilin do ta ndërtojmë edhe programin tonë qeverisës, që t'i avancojmë idetë, pikëpamjet dhe projektet. Ju siguroj, se për gjatë katër viteve të ardhshme, qeverisja jonë do të jetë transparente dhe do të funksionojë mbi bazën e respektimit të ligjeve në fuqi.

Dhe për fund, edhe njëherë, më lejoni që nga zemra të falënderoj gjithë qytetarët e Malishevës që më kanë besuar këtë përgjegjësi që po e nisi sot, dhe me emër të Zotit këtë besim e vlerësim do mundohem maksimalisht që t'ua kthej me punë dhe me qeverisje të mirë e transparente.

Faleminderit shumë!


Hajdin Berisha: Në emrin tim personal dhe në emrin tuajin, të gjithë qytetarëve të Komunës së Malishevës ju uroj formimin e institucione, duke nisur nga asamblea komunale, asambleistët si dhe Kryetari i Komunës. Urime gjithë qytetarëve të Komunës së Malishevës!

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora: 10:35.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Antari më i vjetër i Kuvendit

